




Klan Kosova
Adriatik Kelmendi
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me rastin nr. 2021/23 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Klan Kosova (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 22 dhjetor 2017 ka miratuar Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, me të cilën janë përcaktuar parimet themelore të komunikimeve komerciale audiovizuale gjatë emetimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale, duke përfshirë përmbajtjen, çështjet etike dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale audiovizuale.
2. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Rregulloren KPM-2017/07, ex officio ka iniciuar monitorimin e këtij subjekti me datën 17 janar deri me 2 shkurt 2021. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 17 dhe 31 janar 2021 ka transmetuar program audiovizual të sponsorizuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
3. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 4 shkurt 2021, i ka dërguar Palës përgjegjëse Shkresë, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e gjetura dhe e ka udhëzuar që të ofrojë sqarime lidhur me transmetimin e programeve të sponsorizuara nga partia politike.
4. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Klan Kosova, në lidhje me shkresën e dërguar.

Analiza ligjore

5. Komisioni i KPM-së, gjen se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
6. KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka transmetuar program audiovizual të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) para fillimit të fushatës, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07, i cili përcakton se:

“Partitë politike dhe koalicionet nuk do të jenë sponsorë të programeve audio-vizuale përveç gjatë kohës së promovimit zgjedhor në pajtim me një akt të veçantë.”

7. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Vendim

8. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



11.02.2021
Datë